

DORIAN KEYS
YLLI I MËNGJESIT

BOTIMET TOENA

DORIAN KEYS

YLLI I MËNGJESIT

-12 tregime fantastiko-shkencore në një-

Përktheu nga origjinali anglisht
Xhimi Lazri

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2025

Autori: Dorian Keys
Titulli në origjinal: Morning Star

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo
Korrektore letrare: Majlinda Toçi
Përkujdesja grafike dhe kopertina: Mirjana Madhi

ISBN: 978-9928-348-25-8

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti ose forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it

BOTIMET TOENA

Rr. “M. Gjollesha”, K. Postare 1420, Tiranë

Tel. +355 4 22 40 116

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

toena.al

PËRMBAJTJA

Hyrje.....	7
Ylli i Mëngjesit.....	11
Universi ynë.....	21
Baza Able.....	38
Shpëtimi.....	45
Siguresa.....	56
Iris.....	100
Infektimi.....	134
Eksperimenti.....	161
Luftë.....	199
Eli.....	219
32 të zhdukur.....	246
Kjo nuk është një histori për t'u lexuar në shtrat.....	274
Hansel.....	298
Fundi.....	326
Falënderime.....	333

Hyrje

Do të doja të ndaja me ju një rrëfim me dymbëdhjetë histori brenda.

Gjatë rrugës për në *Helsey 8K*, planeti ku duhej të mbërrinte *Ylli i Mëngjesit* - anija e mbjelljes së embrioneve në hapësirë - pëson një aksident fatal. Një asteroid përplaslet me lidhësin e urës së kabinës së fluturimit, duke vrarë dy persona nga ekuipazhi dhe duke lënë të bllokuar brenda kapitenen Irena Deris.

Për Irenën, mënyra më e mirë që të ruajë qetësinë dhe gjakftohtësinë përgjatë gjithë kalvarit të shpëtimit të saj, madje edhe më pas, është leximi i një libri të shkruar nga Adami, piloti i parë i anijes.

Ekuipazhi arrin ta shpëtojë, por ndonëse ajo pjesë e udhëtimit ka mbaruar, Irena nuk ndahet dot nga libri dhe vazhdon ta lexojë.

Ajo intrigohet nga historitë e robotëve *Meka*, që krijojnë një univers të ri në një përmasë të re kohë-hapësirë. Inteligenca artificiale do të mbrojë dashurinë e saj dhe do

të zhgënjejë pushtuesit alienë. Një arushë prej pelushi do të shpëtojë jetën e një fëmije nga një përbindësh që endet mbi Tokë.

Vendime të çuditshme do t'i kthejnë eksperimentet në makthe, autoritetet do të mashtrohen nga grabitës të mistershëm dhe zemra të thyera do të kërkojnë shpazim.

Lexoni bashkë me Irenën se si ajo shpëton *Yllin e Mëngjesit* dhe bëhuni gati të përjetoni përmasat e një jete krejtësisht të re.



YLLI I MËNGJESIT

Ndërkohë që mbetjet e kabinës së pilotimit dhe trupi i anijes hapësinore *Ylli i Mëngjesit* rrotulloheshin ngadalë rreth vetes, mbi planetin *Helsey 8K* ra drita e një ylli. Adami, piloti i parë, shoi pajisjen me rreze laser dhe vendosi çizmet e kompletit të veshjes hapësinore te një panel, që sapo kishte prerë. Mbajti me duar një tub metalik dhe e shtyu me këmbë, që ta hiqte prej andej.

Tubi u thye dhe instinktivisht Adami e tërhoqi nga vetja. Skaji i sipërm lëvizi djathtas, ndërsa i poshtmi, duke u tërhequr, i bëri një vrimë të vogël në anën e djathtë të pantallonave të kostumit hapësinor.

- Adam, - dëgjoi zërin e Emilisë nga altoparlantët e brendshëm të skafandrës, ndërkohë që një sinjal alarmi njoftonte për humbjen e trysnisë së ajrit.

- Po, e di, - u përgjigj Adami dhe kapi panelin e prishur që kishte përpara. Shtypi një buton digjital dhe shoi alarmin.

- Vetëm një çast, të lutem.

Zgjati dorën majtas për te xhepi i pantallonave të veshjes dhe nxori një copë stofë. E ngriti që ta shihte dhe zhvendosi pjesën ku kishte një shirit ngjitës. Më pas, duke e mbajtur me dorën e majtë, vështroi poshtë, te kofsha e djathtë, ku ishte hapur vrima. E vendosi sipër dhe e shtypi fort.

Duke kontrolluar panelin e dëmtuar vërejti se për momentin e çara ishte mbuluar.

- Adam, - i tha në radio Helmsi, shefi i ekuipazhit, - mos ka ardhur gjë koha të hysh brenda?

- Shef, më ka mbetur edhe ca ajër, - u përgjigj Adami duke vështuar panelin, tashmë të liruuar, të cilin ai e kishte shkëputur prej tubit metalik.

- Adam, u bënë tri ditë që po merremi me këtë. Mos harro se kemi edhe punë të tjera.

Adami hoqi panelin, e largoi nga kabina e dëmtuar dhe e hodhi pas vetes në hapësirë.

- Si thatë, shef?

- Po thosha se me këtë mund të merret dikush tjetër. Tani duhet të përgatitemi për të zbritur në sipërfaqe.

- Unë nuk iki pa marrë edhe atë, shef. Këtu nuk e lë.

- Nuk po them këtë, por unë dua që ta ulësh Gerin në sipërfaqe, në mënyrë që të kryejë kërkimet gjeologjike.

Adami psherëtiu dhe pluskoi përgjatë tubit të trashë plastik, ku gjendeshin fijet e ushqimit për pajisjen prerëse.

Panelet prej çeliku dhe fibre u pleksën me dritaren e rrumbullakët duke ia bërë edhe më të vështirë daljen. Adami

mbylli pajisjen prerëse dhe pluskoi te pjesa e sipërme e strukturës, për të këqyrur kabinën nga jashtë. Mbrojtëset e trasha të dritares ishin mbyllur dhe në një segment të caktuar hapësira midis tyre ishte dhëmbëzuar. Adami nuk u mor me tubin metalik, që fillonte te lidhësi i urës, por pluskoi për te pjesa e përparme në mënyrë që ta këqyrte më nga pranë. Këtu nuk ka rrjedhje ajri.

- Të paktën, më lejoni të pastroj rrugën për te dritarja e daljes!

Adami kapi me forcë dorezën e prerëses të veshur me gomë. Ishte e gjatë dhe përbëhej nga dy pjesë; e poshtmjja lëshonte rreze laser që reflektoheshin tek e sipërmja. Mbështetej nga një fletë metalike, që shërbente si sharrë, por dhe duke qenë se ishte edhe me laser lëshonte nxehtësi tepër të lartë; ishte e përkryer për prerjen e paneleve të vogla metalike.

Linja kryesore, që kalonte nëpër gjatësinë e anijes, nuk ishte thjesht rreze. Në të gjendej një rrjetë e veçantë e përbërë nga disa lloje metalesh, që ishte projektuar enkas për të krijuar një skelet, me të cilin lidheshin të gjitha pjesët e ndryshme të dyshemesë. Kësisoj, ishte shumë e vështirë të pritej vetëm nëpërmjet nxehtësisë.

- A kemi ndonjë lajm nga Irena? - pyeti Adami, që ndezi pajisjen, tek pluskonte në anën tjetër, duke u përpjekur të shmangte cepat e dhëmbëzuara të panelit.

- Jo, - u përgjigj Emilia, operatorja e urës së komunikimit.

Adami e shtyu panelin e prerë tutje nga anija. Ky fluturoi nëpër hapësirën e errët përballë, ku po orbitonte *Ylli i*

Mëngjesit. Adami vështroi në drejtim të kabinës dhe sytë i zunë diçka të njohur. Ishte pjesë e një skafandre shumë të ngjashme me të tijën, e kapur te një shirit. E tërhoqi ngadalë dhe pa se nga brenda ishte bërë me gjak.

Ai e futi copën e mbetur të skafandres në një çantë aty pranë e më pas vazhdoi punën për të prerë shiritat e vegjël që të hapte rrugën drejt dritares së rrumbullakët.

- Adam, të kanë mbetur vetëm dymbëdhjetë minuta rezerva oksigjeni, - i tha Emilia. - Lëre pajisjen dhe kthehu. Eriku dhe Violeta janë bërë gati të të zëvendësojnë.

Adami preu edhe rripin e fundit dhe e flaku tutje, bashkë me copa të shumta xhamash të thyer. Në hapësirën që u krijua, dolën shumë panele të vogla.

- Oh, e shoh anijen, - ai vazhdoi të shtynte me shpejtësi copërat e mbetura pas, ndërkohë një sinjal, që dëgjohej nga brenda veshjes hapësinore, e njoftonte se i kishin mbetur më pak se dhjetë minuta oksigjen.

- Na mbërriti sinjal, - i thanë nga pika e kontrollit. - Adam, na mbërriti një sinjal.

- Irena? - pyeti Adami duke parë nga kabina, ndërkohë që copërat pluskonin tutje.

- Jam duke marrë sinjale prej saj, - vazhdoi pika e kontrollit. - Duket se ndërhynte paneli që sapo hoqe.

Duke shmangur copat e mbetura dhe telat që dilnin jashtë nga tubi lidhës i urës së dëmtuar, Adami u afrua dhe vështroi brenda kabinës përmes dritares së rrumbullakët. Brenda paska dritë. E qëllloi dritaren me një copë metali nga ato që kishin mbetur. Në hapësirë nuk dëgjohen zhurma,

por ai e merrte me mend se Irena, që kishte mbetur aty brenda, ishte ende e vetëdijshme dhe mund ta ndiente praninë e tij.

Ashtu edhe ndodhi.

Irena pluskoi deri te dritarja me sytë vigjilentë dhe me buzën në gaz. Adami lëvizi djathtas dritares dhe nxori një pajisje komunikimi me koneksion urë-urë. E lidhi me veshjen e tij dhe duke shmangur lidhjen me radio tha:

- A më dëgjon?

- O Zot, po! - Irena rregulloi mikrofonin te kufjet dhe vështroi Adamin nga pas dritares së rrumbullakët.

- Gëzohem shumë që po të shoh, zemër. - Adami vuri dorën e mbështjellë me dorezë te dritarja. - Pak më parë u tmerrova për ty.

Irena mbështeti dorën pranë asaj të Adamit te xhami i trashë me tri shtresa i dritares.

- Po mendoja se nuk do të vinte askush të më merrte. Nuk di as ku ndodhem.

Ajo u mbush me frymë që të mbante lotët, ndërsa Adami u gëlltit që të mbante të vetët.

Brenda veshjes së Adamit ra dy herë sinjali.

- Po të mbaroka oksigjeni? - pyeti Irena, pasi e njihte mirë atë sinjal. - Sa kohë ke këtu? Sa larg ndodhem nga pjesa tjetër e anijes?

- Nuk je shumë larg. Ndërlidhësi i urës ishte prishur krejtësisht dhe të gjitha telat përforcues ishin mbështjellë rreth kabinës.

- Çfarë ndodhi, Adam?

- Vlerësimi përfundimtar që kemi bërë është se një asteroid ka çarë korridorin kryesor lidhës, duke e nxjerrë jashtë përdorimit. Na mungojnë tre nga tanët: Uintersi, Pirsoni dhe Miniku. Pjesa tjetër e *Yllit të Mëngjesit* është shëndoshë e mirë. Po ashtu edhe ekuipazhi. Vendi ku ruajmë embrionet ka shpëtuar, - i bëri të ditur Adami duke ndrequr një tel që i tundej përpara skafandrës.

- Tre të vdekur! - thirri Irena.

- Thamë se ju humbëm të gjithëve, - psherëtiu Adami. - Zemër, u bënë tri ditë që po pres copat e mbetura.

- Lavdi Zotit që të paktën shpëtuan foshnjat, Adam. Përse nuk e pamë kur po afrohej?

- Sinjalet fillestare të radarëve mbi lëvizjen e planetit ishin të sakta. Incidenti nuk kishte të bënte aspak me lundrimin. - Adami vuri dorën te dritarja. - Ne nuk e vumë re se në atë sistem gjendeshin grupe asteroidesh. Të paktën në një pjesë të tij. Ato ngjanin më shumë me copa të një hëne të thyer, të mbledhura në një zonë të përbashkët. Mendojmë se ky grup asteroidesh lëviz në orbitë, duke përshkuar trajektore vezake. Kur mbërritëm tri ditë më parë, grupi nuk dukej pasi e fshihte planeti. Qysh atëherë kemi arritur të rikthejmë internetin për pjesën më të madhe të sistemit tonë, por na duhet të përditësojmë disa lëvizje të reja. Pas analizave të mëtejshme që kryem, Geri duket shumë i sigurt se planeti ka shpëtuar. Të paktën ajri është i pastër. Si është gjendja aty te ti?

- Procesori i emergjencës atmosferike është në gjendje pune, bateritë duket se ushqehen mirë dhe kam katër shporta me ushqime.

Irena lëvizi paksa kokën në mënyrë që Adami të shihte çantën shumëngjyrëshe të vendosur në mur te një rrjetë mbajtëse.

- Nga përplasja, - shtoi, - duhet të jetë goditur trupi i anijes pasi çantat humbën rrjetat. A mund të kontrollosh?

- Kam kontrolluar. Del se është dëmtuar kanali i bllokimit, i cili nuk mund të riparohet. Jashtë, mu sipër dritares, ka dalë një si punë thepi, por nuk shikoj ndonjë rrjedhje në atmosferë. Për mua kjo duhet të jetë arsyeja përse kanë humbur rrjetat.

- Mirë, procesori i ajrit ma tregon në rregull sinjalin në bord. Nuk besoj të ketë rrjedhje, por do të kontrolloj prapë. Kam nxjerrë edhe disa çanta të tjera emergjence.

- Për raste të tilla i kemi, - Adami vuri buzën në gaz.

- Çfarë ka për të qeshur?

- Asgjë. Jam i gëzuar që po të shoh. Kujtova se të humba.

Vështruan njëri-tjetrin në sy për disa çaste.

- Veshjen hapësinore e kam këtu, - tha Irena - Po të dua mund ta hap dritaren e rrumbullakët, por nëse duam të ruajmë të dhënat, kam nevojë për drive-rët e transportit të emergjencës.

- Për momentin je më e sigurt atje ku ndodhesh. Unë po dal jashtë. Jemi duke punuar për të ndrequr edhe radion; ti vazhdo të përpiqesh herë pas here.

Irena uli kokën dhe sytë i shkuan vetvetiu te çorapet e bardha që kishte veshur.

- Je tepër i qetë, po ki parasysht gjendjen time të vështirë. Mos harro se një emocion sado i vogël, mund të bëjë dallimin...

- O Perëndi! Irena, po bëj sa mundem që të ruaj gjakftohtësinë dhe nuk dua të të frikësoj. Pesëmbëdhjetë minuta pas përplasjes u gjenda pa veshjen hapësinore, duke mbledhur trupa që pluskonin. Gjëja e parë që bëra ishte të të kërkoja ty. Dhe s'të gjeta.

- Mirë jam, - iu përgjigj Irena. - Më vjen keq, por nuk e pashë që po vinte.

- Këtë e diskutuam një herë dhe nuk është gabimi yt. Mos u merr më. - Sinjali ra tri herë brenda veshjes së Adamit. - Tani bëj mirë të kthehem përpara se të më mbarojë oksigjeni, - tha. - Do të vijë dikush të të marrë. Shefi dëshiron të dërgojë anijen e parë në sipërfaqe dhe të lëshojë satelitët e komunikimit.

- Mirë, nxito. Dua të dal prej këtu.

- Do të bëj ç'është e mundur, Irena.

- Po unë çfarë duhet të bëj ndërkohë?

- Do të vijë një skuadër për të më zëvendësuar mua. Tani që e pastrova rrugën, jam i sigurt se është vetëm çështje kohe derisa të mbërrijnë.

Ranë katër sinjalet, të cilat bënë të ditur se Adamit duhej të kthehej urgjentisht tek *Ylli i Mëngjesit*. Ai zgjati dorën e mbështjellë me dorezë që të vishte xhakëtën me kufje, por u kujtua se duhej t'i thoshte diçka Irenës.

- Oh, më duket se çanta ime është te kabina e pilotimit. Atje duhet të jetë edhe libri.

- Libri yt? - Irena ndreqi mikrofonin dhe ktheu kokën që të shihte çantën e varur te paneli anash saj. - E ke pasur me vete gjithë kohën dhe e ke mbajtur sekret?

- Po, mendoja se duhet të ishte dhuratë. Doja të ta jepja ty pasi të zbrisnim. Tani mund ta hapësh.

- Do të përpiqem të pres.

- Mirë, po deshe ta lexosh, atje e ke.

Adami u largua nga dritarja e kabinës.

- Irena më duhet të kontrolloj anijet e ikjes.

Fiku kufjet dhe u zhduk në të djathtë të dritares.

Irena vendosi cepin e kufjes te stofi me material të ashpër te dera e bllokimit, më pas lëvizi për te grila që mbante çantat e mbushura me ushqim dhe me furnizime të tjera. Rrëmoi për të parë gjendjen. Në të katër çantat kishte ushqim të thatë dhe pako me ushqim ushtrie. Po ashtu kishte edhe dy qeska me ujë dhe...

- Oh, - ia bëri kur pa çantën e Adamit.

Tërhoqi zinxhirin dhe gjëja e parë që pluskoi jashtë, ishte një libër i vogël plot me shënime, hijezuar me të verdhë. Ajo hapi faqen e parë.

TREGIME TË SHKRUARA PËR TY

Një libër nga Adam Kejs

- Hm. - Irena ktheu fletën e tregimit të parë. Pluskoi deri te kabina dhe u ul te poltrona e pilotit. Mbërtheu tokëzën dhe nga paneli sipër vetes drejtoi poshtë dritën e vogël të leximit. Ktheu fletën e kopertinës dhe lexoi titullin e tregimit të parë.



UNIVERSI YNË

- **A**e more? - pyeti Ruanasi Xhean, ndërkohë që po e ndihmonte të ngjitej.

- Po, por mezi e nxora dhe nuk besoj se atyre do t'u vijë mirë. - Merrte frymë me zor dhe vështroi pas, te paneli i fluturimit, ku ishin vendosur pajisje gjuajtëse ndërkohë që dera e avionit të tyre bombardues u vulos duke kërcitur .

- Nuk prish punë. Shpejt e gjitha kjo do të mbarojë. - Ruanasi rregulloi topin me rreze laser, të montuar te supi sipër kostumit mekanik, dhe e afroi sa më tepër që mundi. - Po afrohemi te hyrja e përmasës së re kohë-hapësirë. Mund t'ia dalim.

- Patjetër, - miratoi Xhea duke nxjerrë një si rrjetë mbyllëse, që dukej si prej teli dhe e vendosi atje ku rridhte një energji e bardhë, e përdredhur që ndriçonte me një dritë të fortë e të bardhë aty rrotull.

Të dy u drodhën nga një gjënim i fortë dhe u mbajtën te pajisjet e zonës së ngarkesave të avionit. Një çast më pas, u dëgjua një sinjal alarmi dhe ata nxituan të shkonin te kabina e pilotimit, të lidheshin mirë te poltronat.

- Vendosa parametrat e fluturimit, por s'na mbetet tjetër veçse të presim që ata të bëjnë gjithë ç'munden për të na shfarosur. Qoftë edhe sikur t'u duhet të shkatërrojnë tërë universin bashkë me ne.

Hapësira e errët dhe e qetë yjore, e cila rrethonte stacionin, papritur u trazua nga pamja e dy dritave të ndërprera përreth perimetrin të sigurisë. Befas, dritat u bënë të kuqe dhe plasën duke shkaktuar një shpërthim të brendshëm që çau stacionin orbital në njërën anë.

Nga vrima e krijuar prej shpërthimit doli një avion i vogël luftarak, i cili tërhoqi pas vetes copat e krijuara. Njëkohësisht me të u aktivizuan një mizëri dritash magnetike sigurie.

Ruanasi vështroi sipër dhe ndërkohë avioni i tyre u stabilizua.

- Si po ndihesh?

- Mirë jam.

Xhea shtypi disa butona te një panel sipër poltronës ku ishte ulur që të rregullonte parametrat e fluturimit.

- Më pëlqen shumë kur të shoh si jep e merr me këtë, - e qesëndisi Ruanasi.

- Të pëlqen zhurma, apo jo? - iu përgjigj Xhea me buzën në gaz.

Ruanasi picërroi sytë.

- Për sa kohë që... - nisi të thoshte, por fjalën ia la në mes një sinjal alarmi i dërguar nga inteligjenca artificiale e anijes, që njoftonte një goditje të afërt. Vështroi përpara ekranin e radarëve dhe mori kontrollin e avionit. Rriti gradualisht shpejtësinë dhe e kaloi fluturimin në modalitet rrokullisjeje, në mënyrë që të shmangte mizërinë e minave magnetike që e ndiqnin nga afër. Ndërkohë nga një stacion hapësinor i largët ishin lëshuar avionë të tjerë luftarakë.

- Po aktivizojmë kundërmaset e fushës magnetike, - njoftoi Xhea, duke shtypur një seri butonash në panelin që kishte përballë dhe avioni u drodh lehtëazi.

Ruanasi shtoi shpejtësinë e avionit ndërkohë që dy kundërmasa të fushës magnetike dolën në orbitë nga zona e pjesës së lëvizshme. Kur arritën në njëfarë largësie nga avioni, ato filluan të rrotulloheshin pranë njëra-tjetrës, duke u afruar gjithnjë e më shpejt. Më pas krijuan një fushë magnetike. Kjo tërhoqi gjurmuesit dhe i shkatërroi në një vorbull të krijuar prej saj.

Tufa e gjurmuesve ra nën breshërinë e të shtënave të topave dhe raketave, të cilat ishin drejtuar për tek avioni

që po largohet. Ruanasi bëri një lëvizje rrotulluese, iu shmang raketave dhe predhave. Në këtë çast të shkurtër luftimi, kur ata sapo kishin vjedhur pajisjen e vogël, për të hapur përmasën e re kohë-hapësirë, një flotë e tërë me avionë bombardues po vinte me shpejtësi drejt tyre. Pasi përfunduan një trajektore rrethore, ata lëshuan raketa shpërthyes duke i tërhequr minat magnetike, njëherazi duke flakur tutje reaktivët që përpiqeshin të shpëtonin.

- Kabina e shtrysnimit! - njoftoi kompjuteri, teksa cifla e një rakete u përplas me trupin e avionit dhe krijoi të çara e vrima, prej nga zuri të dilte me forcë ajër.

- Zemër, ndërro drejtimin sa t'i heq qafe këta tipat, merr njësinë tënde me robotë luftimi meka e nxirre jashtë.

Ruanasi fiku alarmin dhe sistemi i mbështetjes së elementeve vitale filloi të kompensonte humbjen e shpejtë të ajrit që pompohej brenda në kabinë.

- Ruanas, jo. Dua të jem atje me ty. - Xhea ngriti zërin sipër zhurmës së ajrit.

- Besomë! Do të rri pas teje. - Ai kapi me të dyja duart skafandrën, e ngjeshi mirë në kokë, ndërkohë që anija përpiquej të ruante kursin e fluturimit.

Xhea zbërtheu skafandrën që e mbante te karrigia dhe shkoi te zona e ngarkesës, ku gjendeshin kostumet meka. U fut brenda kostumit të saj ndërkohë që avioni bëri një kthesë dhe topat e ndjekësve përballeshin me minat magnetike. Ruanasi hapi zjarr ndaj armiqve, të cilët shpërthenin dhe linin një shtjellë shkatërrimesh pas. Ndërkaq kompjuteri njoftoi:

- Procedura e hedhjes jashtë fillon për tre, dy, një.

Brenda një çasti, dera e pasme e avionit u hap, u lëshua pajisja e Xheas. Kur mbërriti në njëfarë largësie nga një armik që fluturonte me shpejtësi, shtytësi, që orientonte drejtimin e robotit të saj, hapi zjarr dhe ajo pati mundësi ta ndiqte. Njëkohësisht, u ndanë edhe minat dhe ndjekësit magnetikë me drita: disa ndoqën Xhean, disa shkuan pas Ruanasit. Ky hapte zjarr, duke i hedhur në erë.

Xhea përshtati parametrat e fluturimit dhe zgjati topin që kishte në supin e djathtë. Ky filloi të hapte zjarr automatikisht ndaj armiqve që i ishin afruar shumë, ndërkohë që ajo bënte edhe manovra pilotimi në mënyrë që t'i shmangte. Në një çast vetëtimthi shqoi Ruanasin që luftonte me një tufë armiqsh. Lëvizti avionin për të shmangur raketa që tani e kishin rrethuar rrezikshëm.

Meka i saj po ndeshej më vete dhe po përballej me armiqtë. Xhea i asgjësoi me top dhe u kthye për të shkuar pas Ruanasit, por pa se avioni që drejtonte ai kishte shpërthyer. Ciflat ishin shpërndarë gjithandej dhe ajo priste të shihte mekan e tij, por... asgjë.

- Jo, zemër, jo! - ia bëri ajo me dëshpërim. Deshi të hynte në mes të ciflave që ta kërkonte. Për fat të keq, mekës i duhej të përballej me diçka më urgjente, pasi pjesa tjetër e raketave po drejtoheshin për nga ajo. Xhea ndërroi kursin e fluturimit duke bërë rrotullime të paparashikuara.

Copat e avionit vazhduan trajektoren drejt përmasës së re kohë-hapësirë gjithnjë duke e ruajtur ritmin, ndërkohë që Xhea detyronte njësinë e saj meka të lëvizte drejt tyre.

Kur iu afrua ciflave, ajo ndjeu se pjesa tjetër e tufës me avionë pas saj ishte ende aktive dhe po e kërkonte. Vështroi nga paneli i informacionit në krahun e saj të majtë.

- Kundërmasat janë aktive. Kemi tetë bombola në gjendje.

- Përdori të gjitha kundërmasat, - urdhëroi ajo *mekan*. U drejtua për nga copat, që tani ishin në vijë të drejtë dhe shtiu me të dy topat që mbante në supe. Dy shpërthimet e para e të flakëritura u ngritën lart. Pas tyre erdhën edhe tri të tjera, duke krijuar kështu dy krahë përgjatë kursit të fluturimit, ndërkohë që minat dhe raketat e vogla, që shkonin pas nxehtësisë dhe magnetizmit të krijuar prej tyre, ndalën.

Tani që, për momentin, nuk kishte armiq pranë, Xhea kapi kabinën e dëmtuar dhe depërtoi brenda.

Ai nuk është këtu. Ajo vazhdoi të futej edhe më tej në brendësi deri te fundi i zonës së pajimeve, ku duhej të ndodhej kostumi i mekas së Ruanasit. As kostumi nuk ndodhej atje.

Hapësira e errët yjore tani ishte plot me mina magnetike, me predha dhe raketa me rreze infra të kuqe, që po drejtoheshin për nga mbeturinat e anijes, çka në bazë të vetisë së inercisë po vazhdonte të lëvizte drejt përmasës së re kohë-hapësirë. Duke qenë se ndjeu edhe një tjetër *meke* të lëvizte, kursi i fluturimit ndryshoi menjëherë.

Zemra e Xheas zuri të rrihte më shpejt kur pa Ruanasin, që po rrokullisej në hapësirë, jo shumë larg saj dhe po vinte në zbatim kundërmasat e tij, duke formuar një rreth të madh, si një brerore drite. Ai i përfundoi manovrat përballë saj,

duke përdorur pjtën magnetike që kishte në kraharor dhe duke e tërhequr Xhean drejt vetes nëpërmjet pjtës së saj. Pa vonuar, që të dy drejtuan topat e supit kundër armiqve që po afroreshin.

- Zemër, i ke çelësat me vete?

- Po, po, i kam! - tha ajo.

- Mirë. Tani është koha e tyre.

Ruanasi vuri në përdorim shtytësit si edhe topat, që kishte secili në të dyja supet dhe zunë të hapnin zjarr, duke shfarosur minat magnetike që synonin vazhdimisht drejt tyre.

- Mbaje. Unë nuk e di se ku po shkojmë, por atje ata nuk do të jenë në gjendje të na ndjekin. Pa çelësin, jo të paktën.

Mbyllja, prej rrjete me tela, që mbante energjinë e bardhë, hollohej sa më shumë që *mekat* shkonin tek e çara. Drita e tyre ndriçonte energjinë e errët e të valëzuar të përmasës kohë-hapësirë, pezull në ajër, ndërkohë që ata të dy fluturonin në një vijë të drejtë, në brezin e fundit ku duhej të hynin. Rreth tyre dendësia u shtua, ndërsa në kohë-hapësirën rreth tyre u shfaqën valë.

- Rrezatimi i neutroneve në rritje, - u dëgjua njëkohësisht nga të dy *mekat*.

Përmasa e re kohë-hapësirë nisi të valëzohej teksa mbyllja u zhduk krejtësisht për momentin, duke lëshuar rrezatim dhe energji dhe duke krijuar një të çarë, përmes së cilës ata mezi kaluan. Ajo u mbyll fill pas tyre, ndërkohë që një palombar u pushtua nga ujërat, duke u zhytur menjëherë

dhe duke dërguar pas vetes valë antimaterie, që asgjësuan anijet, raketat dhe predhat.

Gjithçka nisi në kuadratin e jashtëm, ku Xhea dhe Ruanasi më në fund gjetën shkëndijën që kërkonin. Disa e quanin çelës, disa të tjerë e quanin forcë e jetës. Ata të dy e quajtën thjesht jetë e re, një përmasë e re e lirisë së rregullave të universit të vjetër. Por i ashtuquajtimi Kolektiv kishte rregullat e veta dhe fakti që habitati i tij ishte vendosur te përmasa e re kohë-hapësirë, e forconte shumë atë.

Mijëra, ndoshta miliona vite më parë, një burrë, ndërkohë që po gërmonte për metale të çmuara në një fushë asteroidi, gjeti një objekt të vogël sa dora e tij. Objekti, i rrethuar nga një rrjetë metalike e mbyllur, lëshonte një energji të shndritshme. Ua tregoi kërkuesve të metaleve të çmuara, që gjendeshin aty rrotull, por ata i thanë se nuk kishte vlerë. Burri e mori objektin dhe e vendosi te paneli i aparaturave të anijes së tij të pastrimit të hapësirës. Një grimë më pas, kur donte të ulej mbi një asteroid, për të vazhduar me metalet e çmuara, i ndodhi një aksident. Anija e tij zuri të humbiste presion. Nga frika se mos ngecte në cekëtinë dhe vdiste në mes të askundit, lëshoi një mallkim për sistemin diellor më të afërt. Anija automatikisht nisi të shkonte me shpejtësi drejt tij, por ndërkohë ndodhi diçka. Për shkak të shpejtësisë sistemi i lundrimit i shpërfilli rreziqet ekzistuese dhe fluturoi pranë një hapësire, për të cilën të gjithë thoshin se ishte një vrimë e zezë. Atje, askush nuk ishte afruar aq

shumë për ta ekzaminuar sepse, si me thënë, ato shkaktonin vdekjen pa e zgjatur shumë. Ndërkohë, stringlës që ai kishte gjetur i kishte ndodhur diçka e çuditshme: zuri të bëhej gjithnjë e më e bardhë dhe drita e saj pushtoi tërë kabinën. Kur anija kozmike e kaloi vrimën e zezë, objekti u kthye në gjendjen e tij normale.

Burrit iu shtua kërshëria. *Nuk kam parë kurrë diçka të tillë.* Në përpjekjen që ndodhia të përsëritej, ai shkoi përsëri te vrima e zezë, por u përball me diçka tjetër. Stringla zuri të largohej nga vendi ku ai e kishte vendosur. Një vrimë tek anija e tij e thithi fort dhe ajo fluturoi dhe u fut brenda vrimës së zezë. Menjëherë më pas, hapësira rrotull së çarës u valëzua sikur të ishte ujë. Kësaj radhe ai kishte ardhur i përgatitur, pasi nuk donte të ngecte në cekëtinë e kështu kishte marrë me vete numrin e telefonit të një rimorkioje shpëtimi. Ndërkohë që po priste të mbërrinte anija e shpëtimit, dalloi hapësirën dhe yjet në anën tjetër të vrimës së zezë. Në vështrim të parë iu duk sikur po shikonte një imazh të valëzuar të yjeve pas vrimës së zezë, por sakaq e kuptoi se ishte duke kërkuar brenda saj.

Kjo ishte një hapësirë brenda hapësirës.

I habitur, burri shkoi te dikush që merrej me metalet e çmuara dhe e pyeti nëse kishte parë ndonjëherë objekte të tilla. Për habinë e tij të madhe, tjetri iu përgjigj se tek ai vinin e shkonin persona me të tillë gurë, por askush e nuk dinte për çfarë përdoreshin dhe i konsideronin thjesht si *mbetje që krijohen nga shpërthimi i ndonjë "supernove"*.

Burri vazhdoi të merrej me kërkimin e objekteve të tilla. Arriti të gjente edhe disa gurë të tjerë dhe pa se ishin po

aq të bukur si edhe i mëparshmi, të rrethuar nga një rrjetë metalike dhe çlironin energji. Po ashtu, zbuloi se sa herë që e hidhte ndonjërin, në atë që tani ai e quante përmasë e re kohë-hapësirë, një përmasë e re do të krijohet brenda asaj ekzistuese.

Duke e mbajtur këtë të fshehtë vetëm për vete, ai pajtoi disa pastrues që t'i gjenin dhe t'i sillnin të tjerë çelësa për të hyrë në përmasën e re kohë-hapësirë. Filloi të hapte fjalë se ato ishin objekte të rrezikshme dhe se, po t'i përdornin për t'u futur në këtë përmasë të re, universi ynë do të kishte pasoja.

Pastaj ndodhi e pashmangshmja.

Një grup pastruesish të pandershëm po përpiqeshin të hidhnin një objekt të tillë brenda vrimës së zezë në qendër të galaksisë, ku gjendej sistemi i tyre diellor, por ai plasi. Vijoi një shpërthim, që zhdukua tërë galaksinë dhe bëri që vrima e zezë në qendër të saj të gllabëronte gjysmën e yjeve dhe të shpërndante yjet e tjera. Humbën jetë të panumërta. U zhdukën qytetërimi.

Kjo katastrofë shërbeu që të konfirmonte konstatimet e tij. Këta çelësa për të hyrë te përmasa e re kohë-hapësirë nuk funksionin kudo. Vrima e zezë, që kishte parë ai, nuk ishte si të tjerat. Ajo ishte e vetmja përmasë kohë-hapësirë që kishte parë ndokush.

Falë kësaj, ai krijoi atë që e quajti Kolektivi. Qëllimi i tij ishte mbrojtja e universit tonë nga shkatërrimi. Në të njëjtën kohë, çelësat ua shiti atyre krijesave të pasura dhe atyre njerëzve, të cilët donin të hynin te përmasa. Kësisoj, ky njeri u bë i famshëm.

Mirëpo gënjeshtër i ka këmbët e shkurtra, pasi për këtë përmasë të re kohë-hapësirë filluan të dëgjonin gjithnjë e më tepër pastrues hapësirorë dhe numri i atyre që përpiqeshin të hynin në të u shtua. Për këtë qëllim, Kolektivi ndërtoi aty pranë një vendngulim, që u quajt qendër tregtie. Qëllimi i saj i vërtetë ishte që të ndalonte pastruesit të hynin vetë te përmasa.

Ruanasi dhe Xhea, dy pastrues hapësirorë, përpiqeshin për një jetë më të mirë duke shkuar sa nga një punë në një tjetër. Xhea kishte qenë gjithmonë “zhurmëmadshe”, në kuptimin që nuk kishte frikë të përfshihej në situata të vështira. Ajo gjithmonë kërkonte t’i ngarkonin detyra sfiduese. Herën e fundit mezi kishin arritur të dilnin nga mjegullnaja e neutroneve. Ruanasi përpiquej të bënte sa mundej në çdo situatë ku gjendeshin dhe hiqej sikur ankohej për “zhurmën” e saj. Në të vërtetë atij i pëlqente si “zhurma”, ashtu edhe vetë Xhea. Ai e dinte se ajo “zhurma e saj” e bënte ekzistencën e tyre më të përballueshme.

Nga sa dinin ata, hyrjen në një përmasë të re nuk e kishte synuar kurrë askush tjetër përveç Kolektivit. Ky dhe pjesëtarët e tij nuk do të lejonin që kjo të ndodhte përsëri, të paktën jo pa miratimin nga ana e Kolektivit. Edhe ata, që gjenin çelësin, konsideroheshin individë të rrezikshëm, pasi kjo tregonte dëshirën e tyre për të hyrë te përmasa e re kohë-hapësirë. Për ta, Xhea dhe Ruanasi ishin dy individë që përpiqeshin të gjenin mundësinë për të shkuar drejt një universi të ri. Megjithatë, Kolektivi pretendonte zbatimin nga kushdo një për një të të gjitha rregullave, ashtu siç donte ai. Për të mirën e individëve, këtyre nuk lejohej të bënin asnjë pyetje.

Në vendngulimin e madh të Kolektivit gjendeshin të gjitha format e jetës, në të gjitha përmasat. Çelësat, kur ndodhte që dikush i gjente, apo kur ua vidhnin të zotëve, siç ishte rasti i Ruanasit dhe Xheas, përdroreshin nga Kolektivi. Ata shkatërronin me të vërtetë ëndrrat dhe punën e një jete të tërë të pastruesve hapësinorë.

Duke reaguuar ndaj përmasës së re, të paprekur, mekat filluan të treteshin ngadalë. Fillimisht u zhbënë tiparet dhe dalëngadalë u zbuluan format e vërteta të Xheas dhe të Ruanasit, por nën një aspekt tjetër. Trupat e tyre përthithën nga lëkura metalin e djegur dhe fillimisht dolën këmbët, që lëviznin në mënyrë rrotulluese, më pas kofshët e mandej beli i Xheas dhe kraharori i Ruanasit. Topat, që i mbanin anash supeve, po ashtu u shpërbënë dhe në vend të tyre u shfaqën flatra, të cilat u zbrisnin deri poshtë te këmbët. Ato ishin në tërë trupin dhe të dy ngjanin sikur ishin duke pluskuar në pozicionin fetusi. Sistemi i mbrojtjes së jetës u ngrit sipër kokave të tyre si dy brerore të shndritshme, që pulsonin dhe ua ndriçonin trupat.

Xhea lëvizi dorën përpara fytyrës. E ktheu dhe pa çokat prej hekuri. Mandej e bëri grusht dhe e hapi. U shtriq dhe zgjati krahët pas flatrave. Nën breroren e dritës së bardhë preku Ruanasin.

- Zemër, - i tha duke e kapur nga dora. - Ia dolëm, dhe...
Oh, sa ndryshe dukesh!

Ruanasi hapi sytë. Ia shtrëngoi lehtë dorën, që t'i linte të kuptonte se edhe ai shihte ndryshime. Me buzën në gaz nga ndjesia e duarve, që më në fund po prekeshin, ai pa se si flatrat e tij të errëta u hapën instinktivisht dhe i nxorën në pah të gjithë trupin.

- Ku është kostumi i *mekas*?

- Nuk e di.

Xhea i preku muskujt e formuar të barkut.

“Hapësirë - kohë e re, rregulla të reja”, tha me vete dhe pluskoï për të shkuar më pranë tij. Ruanasi u zgjat dhe e puthi në buzë. Pas saj, përmasa e re kohë-hapësirë ishte ende e ndezur dhe e madhe, por e heshtur. Shpërthimet po ndodhnin në anën tjetër. Tani gjithçka dukej tepër e largët, por edhe pranë, aq sa u mjaftonte të shihnin valëzimin e së shkuarës së tyre.

Xhea ktheu kokën, duke parë nga përmasa.

- I kam ende çelësat.

- Ky do të jetë fillimi ynë i ri, zemër. Ne nuk duam të na thonë tiranët se si duhet të jetojmë e si të vdesim.

Ruanasi vështroi Xhean e më pas përmasën e re kohë-hapësirë.

- E mira do të ishte që te ky univers i ri, të mos bënim shumë “zhurmë”, si thua? - vazhdoi ai ndërkohë që Xhea shikonte të çarën.

- Mua më pëlqen “zhurma” që bëj.

Flatrat e saj të bardha u përkulën ngadalë, duke ia lënë vendin pamjes së brerores së bardhë e të shndritshme sipër kokës.

- E pra, erdhi çasti të të them se unë krijoj nga “zhurma” që bën ti. - Ai i lëmoi flokët ndërkohë që i qëndronte pranë, duke vështruar në errësirë këtë përmasë të re. - Këtu do të krijojmë jetën tonë të re.

Xhea vuri buzën në gaz, por vetëm për pak.

- A do ta dinë ata?

Ruanasi zgjati krahun që të prekte të saj in ndërkohë që Xhea mbante në dorë çelësin e përmasës së re.

- Më ndihmo t’ia çliroj energjinë.

Në një lëvizje, ata që të dy trokitën me duar për të thyer rrjetën mbrojtëse metalike, e cila po ripërtëritej ngadalë, në mënyrë që të thyenin diçka si punë kornize që rrethonte energjinë brenda tyre. Duke e ndier se mbyllja edhe pak do të jepej, Xhea pluskoi paksa sipër Ruanasit, duke u rrotulluar gjithnjë e më shpejt derisa çelësat i ikën nga duart dhe qëlluan thellë në përmasën e re.

BAM! Ata mbuluan sytë me flatra, ndërkohë që kohë-hapësira u zgjerua fuqishëm. Lënda dhe antilënda u përplasën me njëra-tjetrën duke e mbuluar universin e ri që po zgjerohej vetëtimthi.

Një shpërthim i madh i shndritshëm njoftoi lindjen e tij.

Universi, zero sekonda i vjetër.

#

- Shiko-shiko, çfarë mënyre ka zgjedhur Adami për të treguar veten.

Irena mbylli librin, vendosi shënjesen në fillim të kapitullit vijues dhe e la të pluskonte sipër kokës, pranë dritës së vogël për lexim. Hoqi mbrojtësen e kraharorit, shoi dritën dhe pluskoi për te dritarja e modulit përballë hyrjes. Kabina u lidh me korridorin e ngushtë, i cili të çonte te pjesa tjetër e anijes hapësinore. Më parë kur vështronte nga dritarja, ajo shikonte hollin, parakthinën pas së cilës shkohej te kabinat e fjetjes dhe te mjediset e tjera. Por, duke qenë se asteroidi e kishte çarë të gjithën anijen, Irena arriti të shihte vetëm sipërfaqen e planetit blu me re të bardha, të shpërndara sipër.

Duke u mbajtur te dorezat prej litari dhe te rripat e çantës me stof, që vareshin te rrjeta e bardhë e mureve, shkoi ngadalë te dritarja e rrumbullakët dhe iu afrua panelit të fuqisë. Në të lexohej *Bateria 68 për qind, në ushqim e sipër, mbani pastër panelet diellore.*

- Për fat të mirë. - Pluskoi edhe ca më tutje te i njëjti panel, ku procesori i atmosferës nëpërmjet një drite LED të gjelbër pulsuese tregonte se gjendja ishte e rregullt dhe se nga trupi i avionit nuk kishte rrjedhje. Më pas ktheu kokën për të parë nga zona e komunikimeve ku ishte radioja.

- Adam, - tha pasi shtypi butonin e transmetimit. Dëgjoi vetëm një heshtje të thyer nga zhurma e bardhë që vinte nga bokset.

- Adam, atje je? - Sërish e njëjta përgjigje me një zhurmë të bardhë. Psherëtiu dhe shtyu mikrofonin.

Pjesa e dëmtuar e trupit të avionit, bashkë me kabinën, bënë një rrotullim dhe një rreze drite nga ylli i sistemit, ndriçoi paksa zonën ku gjendej ajo. Paneli i kontrollit manual shkëlqente nën ndriçimin që vinte nga dritarja e rrumbullakët. Irena qëndronte te rrezja me sytë mbyllur dhe ndiente ngrohtësinë. Kapi një shishe uji, që pluskonte aty pranë, gjerbi një gllënjë të vogël, pastaj zgjati dorën për nga drita e vogël e leximit, që mbahej me rripa te një karrige përballë saj. Kapi dhe një shufër proteinash, që rrinte pezull në ajër dhe lidhi mbrojtësen. Kaloi gishtin në laptop për të shkuar te ditari i fluturimit, e ndezi dhe shkroi te hapësira ku shënohej “Statusi i anijes”.

“Dita e 3-të: Anija mbjellëse *Ylli i Mëngjesit*, në bord gjenden 8.000 embrione të palindura në gjallim të bllokuar. Ekuipazhi aktiv 23. 6 vjet qysh pas shkëputjes nga anija transportuese *Shpresa*. Vendndodhja aktuale: orbita rreth Planetit “Bërthama” i shënuar H#8000, *Helsey 8K*.

Statusi: vlerësimi dhe mbulimi i dëmeve të shkaktuara nga një asteroid, i cili çau korridorin që lidhte kabinën me pjesën tjetër të anijes. Panelet diellore funksionojnë, materia është në gjendje të mirë, procesori atmosferik në gjendje pune.

Objektivi i Misionit: - I plotësuar.”

Irena mbeti në mëdyshje. Vetëm një njeri mund të ndryshonte statusin e misionit dhe ky ishte Adami. Mbylli laptopin dhe zgjati dorën për të marrë librin e vogël me kapak të butë.

Preku shënjesen e faqeve, të cilën e kishte lënë te tregimi i dytë, por sytë i zunë një fletushkë të verdhë.

“Kisha humbur prej ditësh.”

“Por tani ti je këtu.”

“Po, ajo më ndihmoi.”

“Atëherë, në rregull. E arrite këtë.”

Duke kafshuar buzën, pashë poshtë. “Eh, po, tani është gjithçka në rregull.”

Pak e çuditshme, por e bukur. Irena mbylli librin duke e mbajtur gishtin te faqja e tregimit të dytë. Vështroi jashtë dritares së rrumbullakët. Duhet të më kishe pyetur përpara se të bëje ndryshimin, Adam. Pasi vështroi për disa sekonda kabinën e anijes, hapi librin dhe nisi të lexonte rrëfimin në vijim.